

VENDIM
Nr. 770, datë 22.10.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR TRANSPARENCËN DHE
PËRMIRËSIMIN E PROCESIT VENDIMMARRËS NË KËSHILLIN E LARTË
GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, nenit 61, nenit 72–76 dhe nenit 97 pika 1, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të Grupit të Punës për Hartimin e Rregullores mbi Kodin e Etikës dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për transparencën dhe përmirësimin e procesit vendimmarrës në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Ilir Rusi

RREGULLORE
PËR TRANSPARENCËN DHE PËRMIRËSIMIN E PROCESIT VENDIMMARRËS
NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Preambulë

Të vetëdijshëm se duke forcuar transparencën, Këshilli rrit llogaridhënien, nxit besimin publik dhe forcon pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) riafirmon përgjegjësinë e tij për të mbrojtur pavarësinë gjyqësore dhe për të ruajtur besimin e publikut përmes standardeve më të larta të transparencës, llogaridhënies dhe sjelljes etike. Këshilli është i angazhuar të respektojë “Parimin e transparencës”, si një nga parimet themelore që udhëheqin veprimtarinë e tij.

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të vendosë një kuadër të qartë, të aksesueshëm dhe të zbatueshëm për të garantuar transparencën në funksionimin dhe proceset vendimmarrëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), veçanërisht në fushat që ndikojnë në karrierën gjyqësore, si emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet, vlerësimet dhe disiplinën, si dhe në performancën më të gjerë institucionale të tij.

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi i rregullores

1. Rregullorja përcakton rregullat, detyrimet dhe procedurat për zbatimin e transparencës në veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përputhje me parimet e përcaktuara në ligj.

2. Rregullorja zbatohet për publikimin dhe qasjen në informacionin që lidhet me ushtrimin e kompetencave të Këshillit, përfshirë shpalljen e vendeve vakante gjyqësore, emërimet, ngritjet

në detyrë, transferimet, vlerësimet, masat disiplinore dhe vendime të tjera të marra në fushën e karrierës gjyqësore dhe qeverisjes institucionale.

3. Qëllimi i Rregullores është të garantojë zbatimin transparent të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, me synim sigurimin e llogaridhënies, përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe rritjes së integritetit dhe besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Rregullorja zbatohet në të gjitha fushat e veprimtarisë së Këshillit që përfshihen në kompetencat e tij ligjore, përfshirë emërimet, ngritjet në detyrë, transferimet, vlerësimet, procedurat disiplinore, planifikimin strategjik, statistikatat gjyqësore dhe raportimin institucional.

Neni 3

Parimet

1. Veprimtaria e Këshillit udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, llogaridhënies, paanshmërisë, profesionalizmit, eficiencës dhe respektimit të pavarësisë gjyqësore.

2. Në përmbushje të detyrimit për transparencë, Këshilli merr masa të përshtatshme për të siguruar që publikimi i informacionit të mos cenojë dinjitetin personal, konfidencialitetin e procedurave, apo funksionimin efektiv të gjyqësorit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

KREU II

TRANSPARENCA NË EMËRIMET DHE NGRITJET NË DETYRË NË SISTEMIN GJYQËSOR

Neni 4

Publikimi i vendeve vakante në sistemin gjyqësor

1. Këshilli shpall dhe publikon vendet vakante në sistemin gjyqësor ose ato që priten të bëhen vakante, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligj.

2. Çdo shpallje duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe nivelin e gjykatës;
 - b) natyrën e procedurës (lëvizje paralele, ngritje në detyrë, apo emërim fillestar);
 - c) bazën ligjore të procedurës dhe afatet përkatëse;
 - d) kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në nenet 43 deri në 49 të ligjit nr. 96/2016;
 - e) dokumentacionin e kërkuar dhe afatin për aplikim;
 - f) mënyrën e dorëzimit dhe të dhënat për kontakt.
3. Publikimi bëhet në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 5

Kriteret e pranueshmërisë dhe listat e kandidatëve

1. Për çdo shpallje që lidhet me emërimin, ngritjen në detyrë ose transferimin e gjyqtarëve, Këshilli publikon kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në ligj dhe çdo kusht specifik të vendosur me vendim të Këshillit, në zbatim të kompetencave të tij sipas nenit 61 të ligjit nr. 115/2016 dhe neneve 42 deri në 49 të ligjit nr. 96/2016.

2. Kriteret e publikuara përfshijnë:

a) përvojën profesionale të kërkuar, përfshirë vitet minimale të ushtrimit të funksionit gjyqësor, siç parashikohet në nenin 47 të ligjit nr. 96/2016 për ngritje në detyrë;

b) mungesën e ndonjë mase disiplinore në fuqi dhe përmbushjen e kushteve të integritetit, në përputhje me nenin 43, pika 6, të ligjit nr. 96/2016;

c) përvojën përkatëse në fushën e së drejtës që lidhet me pozicionin vakant, sipas kërkesave të ligjit;

d) rezultatet e mëparshme të vlerësimit, në masën e kërkuar nga dispozitat përkatëse ligjore, pa bërë publike pikët e vlerësimit ose të dhënat e performancës individuale;

e) çdo kusht shtesë ligjor apo procedural të përcaktuar me vendim të Këshillit.

3. Në procedurat e lëvizjes paralele, një magjistrat mund të kandidojë për jo më shumë se tri vende vakante të shpallura brenda së njëjtës procedurë, në përputhje me nenin 43, pika 5, të ligjit nr. 96/2016. Kur paraqet më shumë se një kandidim, magjistrati duhet të deklarojë me shkrim renditjen sipas preferencës për secilin pozicion. Nëse kandidon për më shumë se tri pozicione, do të konsiderohen të vlefshme vetëm tri kandidimet e para të paraqitura në kohë ose, kur janë paraqitur njëkohësisht, ato që i korrespondojnë vendeve të shpallura më herët.

4. Pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve formale dhe ligjore, Këshilli publikon listën e kandidatëve të pranuar në procedurë së bashku me preferencat për pozicionet e shpallura.

Neni 6

Publikimi i vendimit

1. Këshilli publikon vendimin e plotë për emërimin, caktimin, ngritjen në detyrë, delegimin transferimin e gjyqtarëve etj., në përputhje me kompetencat e tij sipas ligjit.

2. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit brenda afatit ligjor.

KREU III

TRANSPARENCA NË VLERËSIMIN E GJYQTARËVE

Neni 7

Publikimi i programit vjetor të vlerësimit

1. Këshilli publikon programin vjetor të vlerësimit të miratuar.

2. Informacioni publikohet në faqen zyrtare të Këshillit brenda afatit ligjor.

3. Çdo ndryshim në programin e vlerësimit i cili miratohet nga Këshilli publikohet në të njëjtën mënyrë.

Neni 8

Publikimi i vendimit

1. Këshilli publikon raportin për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit si dhe vendimin përkatës, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të Këshillit brenda afatit ligjor.

KREU IV

PUBLIKIMI DHE ZBATIMI

Neni 9

Baza e të dhënave të brendshme dhe aplikacioni publik për vendet e lira

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor krijon dhe përditëson një bazë të dhënash elektronike të brendshme, për anëtarët e cila përmban informacion të plotë mbi të gjitha vendet e lira, duke përfshirë:

- a) shpalljen e thirrjes për aplikime dhe afatet përkatëse;
- b) listën e aplikantëve dhe dokumentacionin mbështetës;
- c) pikët e vlerësimit për secilin kandidat;
- d) çdo dorëheqje;
- e) renditjen e kandidatëve dhe caktimet në pozicion;
- g) rezultatin përfundimtar, përfshirë emrin e kandidatit fitues;
- i) caktimet për gjykime të posaçme, komandimet dhe delegimet.

2. Këshilli zhvillon dhe administron një aplikacion publik *online*, i cili pasqyron informacion të përditësuar mbi vendet e lira dhe procedurat përkatëse, duke përfshirë:

- a) thirrjet e shpallura dhe afatet;
- b) emrat e aplikantëve të pranuar;
- c) fazat e procedurës;
- d) renditjen e kandidatëve;
- e) emrin e kandidatit fitues.

Aplikacioni publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit dhe përditësohet rregullisht për të garantuar transparencën, duke respektuar njëkohësisht konfidencialitetin dhe dispozitat e ligjit nr. 115/2016 mbi transparencën dhe mbrojtjen e të dhënave.

Shërbimi mbështetës përkatës administron dhe përditëson të dyja sistemet dhe raporton çdo vit para Këshillit mbi funksionimin, përputhshmërinë ligjore dhe respektimin e standardeve të transparencës dhe sigurisë së të dhënave.

Neni 10

Zbatimi i rregullores

Sekretari i Përgjithshëm siguron që procedurat teknike dhe administrative të nevojshme për publikimin e informacionit në kuadër të kësaj Rregulloreje të jenë të përcaktuara dhe të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të standardizuar.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11

Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjitha masat e transparencës që përfshihen në kompetencat e Këshillit, përfshirë edhe ato në proces në momentin e hyrjes në fuqi, përveç rasteve kur zbatimi i dispozitave të veçanta kërkon përshtatje paraprake administrative ose teknike.

2. Këshilli merr masa të garantojë zbatimin e rregullores për një periudhë prej 3 muajsh nga data e hyrjes në fuqi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.